



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONIERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 23.3.2023

Nr: 192

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE PARTIA “LËVIZJA BASHKË” PËR REGJISTRIMIN SI
SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ
2023**

Sot më datë 23.3.2023, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 1800 Prot., datë 21.3.2023, me:

Kërkues: Partia politike “Lëvizja Bashkë”, me kryetar z. Arlind Qori

Objekti: Regjistrimi i partisë politike “Lëvizja Bashkë” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

Baza ligjore: Neni 64 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Partia “Lëvizja Bashkë”, nëpërmjet kryetarit të saj z. Arlind Qori, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën me 1384 datë 6.3.2023 për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 14 maj 2023.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

Data: 23.3.2023 Nr: 192
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Lëvizja Bashkë”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

- a) Shkurtim vendimi me nr. 2, datë 2.3.2023, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Lëvizja Bashkë” me shkronja nistore “BASHKË”, me adresë Rruga “Abdulla Keta”, nr. 1, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është z. Arlind Qori, me adresa, Rruga “Pjetër Budi”, Pall. 62, Shk. 3. Ap. 36, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është z. Xhuliano Bregasi, me adresë, Rruga “Abdulla Keta”, nr. 1, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është z. Viktor Çipi, me adresë, Rruga “Abdulla Keta”, Godina. 9, Shkalla. 4, Ap. 7, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Neni 64, pika 2, shkronja “a”, e Kodit Zgjedhor, parashikon se partia politike për tu regjistruar si subjekt zgjedhor duhet të paraqesi një vërtetim që vërteton se partia është e regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në përmbushje të këtij detyrimi partia politike “Lëvizja Bashkë” ka depozituar Shkurtim Vendimi me nr. 2, datë 2.3.2023, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin vërteton regjistrimin e saj në Gjykatë. Në përmbajtje të dispozitivit gjykata shprehet se ndaj këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit, afat ky që fillon nga e nesërmja e shpalljes së tij. Nga përmbajtja e dispozitivit del qartë se ky vendim nuk është i formës së prerë e si rrjedhojë nuk është i pasqyruar në regjistrin e partive politike të Gjykatës.

Në referim të sa më sipër, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 157 datë 09.03.2023 ka marrë vendim për mos regjistrimin e partisë politike “Lëvizja Bashkë”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e datës 14 maj 2023.

Partia “Lëvizja Bashkë” ka depozituar pranë KQZ-së, kërkesën ankimore me nr.30, datë 11.03.2023, me anë të së cilës kërkonte regjistrimin e partisë “Lëvizja Bashkë”.

Partia Lëvizja Bashkë ka ankimuar vendimin me nr.157, datë 09.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve. KAS në përfundim të shqyrtimit të ankimit, me vendimin nr. 23, datë 14.03.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Vendimi i mësipërm i marrë, është ankimuar nga partia “Lëvizja Bashkë” në Kolegjin Zgjedhor i cili me vendimin nr. 4 datë 21.03.2023 ka vendosur;

- Pranimin e padisë;
- Detyrimin e KQZ të regjistrojë partinë politike “Lëvizja Bashkë” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023;

- Ky vendim është i formës së prerë.

Partia politike “Lëvizja Bashkë” me shkresën nr. 1800 Prot, datë 21.03.2023 ka depozituar në KQZ, kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Bashkëlidhur kësaj kërkesë, dokumentacioni vijues si më poshtë:

- d) Shkurtim vendimi me nr. 4, datë 21.3.2023, të Kolegjit Zgjedhor Tiranë;
- e) Vërtetimin e marrë pranë Regjistrimit të Partive Politike ku rezulton se partia “ Lëvizja BASHKË” me inicialet “ BASHKË” është e regjistruar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, nenit 64, pika 2 të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Vendimit nr. 4, datë 21.3.2023, të Kolegjit Zgjedhor Tiranë.

VENDOSA:

1. Rregjistrimin e partisë politike “Lëvizja Bashkë”, me kryetar z. Arlind Qori, me shkronjat nistore “BASHKË”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI